



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
KRYETARI

URDHËRESË

Nr. 3973, datë 24.01/2019

Për

Një ndryshim në Urdhëresën nr.17118, datë 09.05.2017 mbi "Detajimin në vende parkimi i nënzoneve të destinuara për parkim "NDP" të miratuara me Vendimin e Këshillit Bashkiak, Tiranë nr. 49, datë 11.11.2015 për "Miratimin e kritereve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzoneve të destinuara për parkim, si dhe tarifave të shërbimit të parkimin të administruara nga Bashkia e Tiranës"

Me propozim të "Drejtorisë së Transportit dhe Trafikut Rrugor" dhe për efekt administrimi të nënzoneve të destinuara për parkim me pagesë, në mbështetje të nenit 8, pika 2; nenit 9, pika 1/1.1, shkronja "b" dhe pika 1/1.3, shkronjat "a" dhe "b", nenit 64, shkronjat "a" dhe "b" të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, për "Vetëqeverisjen Vendore"; nenit 7, pika 1, shkronja "e" e pika 10 e po këtij neni dhe nenit 37 të Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit Bashkiak, Tiranë nr. 48, datë 11.11.2015 për "Krijimin e "Tirana Parking" si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë, për administrimin e shërbimit të parkimit publik me pagesë"; pika 4 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 49, datë 11.11.2015 "Miratimin e kritereve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzoneve të destinuara për parkim, si dhe tarifave të shërbimit të parkimin të administruar nga Bashkia e Tiranës",

URDHËROJ

1. Rishikimin, përcaktimin dhe detajimin në vende parkimi i nënzoneve të destinuara për parkim "NDP" – pjesë e ZAP Nr. 1/Nr.2/Nr.3/Nr.4, si më poshtë vijon:
 - a) Rruga "Konti Urani" (segmenti "Kavajes"- Rruga "Durrstit) - sipas projektit bashkëlidhur kësaj urdhërese, referuar Aneksit 3, fleta 1.

- b) Blv. "Zhane D'ark" (segmenti "Rr. Arkitekt Kasemi"- Rruga "Odhise Grillo") - sipas projektit bashkëlidhur kësaj urdhërese, referuar Aneksit 7, fleta 3.
- c) Rruga "Siri Kodra" (segmenti "Dibres"- Rruga "Feri Xhajko") ; - sipas projektit bashkëlidhur kësaj urdhërese, referuar Aneksit 12, fleta 3.
- d) Rruga "Petro Nini Luarasi" (segmenti "Bajram Curri"- Rruga "Besim Habdiu") - sipas projektit bashkëlidhur kësaj urdhërese, referuar Aneksit 13, fleta 3.
- e) Blv."Bajram Curri" (segmenti "Sulejman Delvina "- Rruga "Kavajes") - sipas projektit bashkëlidhur kësaj urdhërese, referuar Aneksit 14, fleta 1.
- f) Rruga "Liman Kaba" (segmenti "Prokop Mima "- Skender Luarasi") - sipas projektit bashkëlidhur kësaj urdhërese, referuar Aneksit 16, fleta 1.
- g) Rruga "Perlat Rexhepi" (segmenti "Deshmorët e 4 Shkurtiti "- Rruga "Ibrahim Rugova") - sipas projektit bashkëlidhur kësaj urdhërese, referuar Aneksit 17, fleta 1.
- h) Rruga "Skender Luarasi" (segmenti "Medar Shtylla "- Rruga "Liman Kaba") - sipas projektit bashkëlidhur kësaj urdhërese, referuar Aneksit 19, fleta 1.
- i) Rruga "Janosh Huniadi"(segmenti "Abdyl Frashri "- Rruga "Adem Jashari")- sipas projektit bashkëlidhur kësaj urdhërese, referuar Aneksit 15, fleta 1.

2. Për zbatimin e kësaj urdhërese, ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Tirana Parking. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Policia Bashkiake, në bashkëpunim me Komisariatin e Qarkullimit Krugor, Tiranë dhe firma ndërtuese e kontraktuar, për zbatimin e kësaj urdhërese,

Kjo urdhëresë hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Erion Veliaj

